

# E drejta për informim

Newsletter mujor mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit

Newsletter është publikim i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

## Fokusi i muajit

**Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë për Informim dhe Privatësi të Kosovës dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale së bashku me Agjencinë për Informim dhe Privatësi të Republikës së Kosovës nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi me karakter teknik midis dy institucioneve. Të dyja autoritetet e mbrojtjes së të drejtës për informim dhe privatësi gëzojnë një marrëdhënie të veçantë mes tyre, por që me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, do të konsolidohet e zhvillohet edhe më shumë.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi bazohet mbi tre shtylla kryesore: shkëmbimin periodik të eksperiencave dhe stafit për rritjen e kapaciteteve profesionale e administrative, në kuadër të modernizimit të legjislacionit në të dy fushat e veprimtarisë sipas standardeve më të përparuara evropiane; mbështetjen ndaj AIP për anëtarësimin në organizata të ndryshme, si Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit (ICIC), Konferenca Evropiane e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (ECDPA), Komiteti Konsultativ i Konventës 108 të Këshillit të Evropës (T-PD), etj; si dhe në njohjen e ndërsjellë si shtete me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale (adequacy), për një zhvillim të qendrueshëm të ekonomisë dhe shkëmbimit midis dy vendeve. Gjatë takimit, u diskutua edhe për mundësinë e zbatimit të projekteve të përbashkëta. Ato kanë si qëllim forcimin e besimit e ndërgjegjësimin për ushtrimin e të drejtave nga qytetarët, paralelisht, me rritjen e transparencës e llogaridhënies së Autoriteteve Publike dhe përgjegjshmërisë e etikës nga kontrolluesit/përpunuesit publik e privat.

## Përmbledhje mujore e vendimeve dhe rekomandimeve

**Vendim Nr. 12 - Ministria e Financave dhe Ekonomisë**

**Vendim Nr. 13 - Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore**

**Vendim Nr. 14 - Operatori i Sistemit të Transmetimit**

**Vendim Nr. 15 - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme**

**Vendim Nr. 16 - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**

# Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

TRANSPARENCA E AUTORITETEVE  
PUBLIKE ËSHTË NJË NGA SHTYLLAT  
E MIRËQEVERISJES

VIZITONI [WWW.IDP.AL](http://WWW.IDP.AL)

## #informim #transparencë #vendim

për parashtrime, zhvillimi i inspektimit si dhe seancës dëgjimore mes palëve.

Lidhur me pretendimin e Autoritetit Publik se nuk është institucion i autorizuar në dhënien e informacionit të kërkuar, Zyra e Komisionerit vlerëson se ky arsyetim nuk qëndron pasi, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Gjithashtu, konstatohet se Autoriteti Publik, citon nenin 27, të Kontratës së Koncesionit që lidhet me me konfidencialitetin, por nga ana tjetër nuk është argumentuar saktësisht se si dhënia e këtij informacioni mund të çenojë apo shkelë këtë parim.

Gjatë hetimit administrativ Autoriteti Publik nuk provoi në asnjë moment, se në cilën pikë të nenit 17, të LDI mbështet qëndrimin e tij lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, pasi është ky nen, i cili parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtës për informim, shkaqet dhe arsyet që mund të çojnë një autoritet publik për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim.

Për rrjedhojë, në mungesë të një dispozite të posaçme ligjore për të legjitimuar diskrecionin e Autoritetit Publik për të kufizuar të drejtën për informim të publikut, nëpërmjet parashikimeve të klauzolave kufizuese dhe përjashtuese të përcaktuar në këtë kontratë, Komisioneri e gjen qëndrimin e mbajtur nga Autoriteti Publik në kundërshtim me LDI.

Ndërkohë, nga verifikimi i legjislacionit të posaçëm që rregullon procedurat e koncesionit nuk rezulton që kontrata e lidhur me subjektin privat apo informacioni objekt kërkimi, të parashikohet si informacion konfidencial, për të autorizuar në këtë mënyrë lidhjen e një kontrate të tillë dhe legjitimitimin e Autoritetit Publik për kufizimin e të drejtës për informim të qytetarëve.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vendosi urdhërimin e autoritetit publik për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar duke respektuar kufizimet në përputhje me pikën 6, të nenit 17, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Për tu njohur me vendimin e plotë të Zyrës së Komisionerit klikoni <https://www.idp.al/wp-content/uploads/2022/01/Vendim-13.pdf>

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit maj 2022, ka dhënë 5 vendime (3 vendime urdhërimi, 1 vendim rrëzimi dhe 1 vendim mospranimi) në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (LDI).

Me anë të vendimit nr. 13 datë 10.05.2022, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj "Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".

Kërkuesi ka kërkuar informacion lidhur me Vendimin nr. 16, datë 03.10.2018 të Këshillit Kombëtar të Territorit në të cilin është vendosur miratimi i lejes së ndërtimit për objektin: "Ndërtimi i HEC-it Sekë dhe Zais, në pellgun ujëmbledhës të lumit të Urakës dhe Zallit të Melthit", si dhe relacionin teknik për projektin, aktin e kolaudimit të projektit, relacionin elektrik dhe raportin e monitorimit të funksionimit të heceve.

Autoriteti Publik në përgjigje të tij ka sqaruar se: "AKBN nuk është institucion i autorizuar në dhënien e informacionit të kërkuar pasi në nenin nr. 27 të Kontratës së Koncesionit, citohet: "Secila nga palët duhet të konsiderojë si konfidenciale të gjitha dokumentet dhe informacionet e tjera në lidhje me projektin, qofshin këto tregtare apo teknike dhe nuk duhet t'ja bëjë të ditura një pale të tretë, të gjithë apo një pjesë të dokumentit apo informacionit, pa miratimin e palës tjetër, përveçse për qëllimin e përmbushjes së kushteve të kësaj kontrate."

Për sa më sipër, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi i është drejtuar Zyrës së Komisionerit duke kërkuar ushtrimin e kompetencave, që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të cituar në kërkesën për informacion.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim "LDI") dhe me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave, që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, Zyra e Komisionerit vendosi zhvillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik duke ndjekur të gjithë etapat e procedurës administrative duke filluar nga kërkesa

## “Dita e Transparencës” me Autoritetet Publike të Qarkut Elbasan

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale zhvilloi në Elbasan takim të dytë në kuadër të iniciativës “Ditët e Transparencës”.

Në këtë aktivitet morën pjesë Prefekti i Qarkut - znj. Majlinda Perriu, Kryetari i Bashkisë Elbasan - z. Gledian Llatja, Kryetari i Këshillit të Qarkut Elbasan - z. Bukurosh Stafa, drejtues dhe përfaqësues në nivel qarku: të njëjtit të vetëqeverisjes vendore, të institucioneve të sistemit të drejtësisë, strukturave rajonale të institucioneve të varësisë dhe koordinatorët për të drejtën e informimit.

Transparenca proaktive dhe llogaridhënia e Autoriteteve Publike, përveçse janë ndër faktorët kryesorë të garantimit të të drejtës për akses në informacionin publik, ndikojnë edhe në përmirësimin e shërbimeve për qytetarët.

Gjatë takimit u vlerësua ecuria e zbatimit të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” nga Autoritetet Publike të këtij qarku. Nga monitorimi dhe analiza e situatës, Zyra e Komisionerit ka konstatuar se kërkohet dinamikë në përditësimin e vazhdueshëm të Programit të Transparencës dhe Regjistrimit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, për elementë të tillë, si shpenzimet buxhetore, procedurat e prokurimit publik apo auditimet, si dhe për procesin e njoftimit dhe konsultimit publik. Njëkohësisht, u kërkua nga koordinatorët rritja e cilësisë në procesin e trajtimit të kërkesave për informacion nga qytetarët apo grupet e interesit, si dhe bashkëpunim konstant me ta për forcimin e kulturës së transparencës.



## Workshop me shoqatën DIHA, për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale në fushën e biznesit



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në bashkëpunim me Shoqatën Gjermane të Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri (DIHA), zhvilluan workshop-in “E drejta e informimit dhe mbrojtja e të dhënave personale në fushën e biznesit”. Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin përfaqësues nga subjekte/shoqëri anëtare të kësaj organizate, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fusha e sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Si dy të drejta dhe liri themelore kushtetuese, ato garantohen nga një kuadër rregullator bashkëkohor, bazuar në praktikat legislative evropiane. Të pranishmit u njohën me rolin, funksionet dhe kompetencat e Zyrës së Komisionerit, si dhe drejtimit kryesorë të veprimtarisë mbikëqyrëse. E drejta e informimit dhe mbrojtja e të dhënave personale bazohen mbi parimet e etikës, përgjegjshmërisë, llogaridhënies, integritetit dhe transparencës. Autoritetet Publike dhe kontrolluesit publik e privat kanë detyrime rregullatore konkrete për t'i përmbushur për të lehtësuar ushtrimin në praktikë të këtyre të drejtave nga qytetarët.

Transparenca proaktive e institucioneve publike është një nga drejtimit kryesorë për një administratë dinamike. Ndërsa, masat e nevojshme tekniko-organizative për përpunimin e sigurt të të dhënave personale janë edhe më të dosmodoshme në epokën digjitale ku jetojmë. Këto standarde nxisin e forcojnë besimin e qytetarëve për marrjen e shërbimeve në kohë e me cilësi.

Workshopin e bashkëdrejtoi përfaqësuesja e Zyrës së Komisionerit, znj. Besa Velaj, Drejtore e Kabinetit.